

MATRICA E KOMPETENCAVE E VETËQEVERISJES VENDORE

Konteksti

Reforma më e fundit e decentralizimit në vend ka filluar me ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe me ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; dhe vazhdon më tej me analizën e ligjeve sektoriale në mënyrë që të ndihmojë në harmonizimin e shpërndarjes së autoritetit në të dy nivelet qeverisëse për secilën fushë të funksioneve të vetëqeverisjes vendore.

Dy raportet e monitorimit të Strategjisë, të hartuara respektivisht në 2016 dhe 2017, kanë gjetur se mungesa e harmonizimit ligjor është e pranishme në shumë fusha të veprimtarisë funksionale të vetëqeverisjes vendore, e veçanërisht në funksionet e reja të cilat i janë transferuar këtij niveli qeverisëse me ligjin 139/2015 dhe në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative të vitit 2015.

Përmirësimi dhe harmonizimi i kuadrit ligjor dhe institucional sektorial është mëse i nevojshëm për të rritur eficiencën e veprimtarisë së njësisve të vetëqeverisjes vendore, që qëndron si vizioni i Strategjisë; gjithashtu siguron zhvillimin e qëndrueshëm të këtij niveli qeverisëse, i cili në vetvete përbën dhe një prej objektivave kryesore të Strategjisë.

Objektivat e projektit

Qëllimi i këtij projektit është të rishikoi informacionin dhe të vendos një kuptim të qartë të roleve ndërmjet tre niveleve të qeverisjes në ekzekutimin e kompetencave të vetë-qeverisjes vendore dhe ofrimit të shërbimeve nga NjQV-të sipas ligjit 139/2015 dhe në kuadër të Reformës Territoriale dhe Administrative të vitit 2015. Gjithashtu, të japë

rekomandime për Ministrinë e Brendshme, përgjegjëse e bashkërendimit me qeverinë vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendor, për hapat që duhen ndërmarrë në vijim për të përmbushur masën e autonomisë vendore të përcaktuar në Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2019.



Rezultatet e Projektit

Rezultati kryesor i këtij projekti është hartimi i Matricës së Kompetencave për Vetë-Qeverisjen Vendore, shoqëruar me rekomandime të qarta për të adresuar pengesat e identifikuara. Për këtë qëllim janë rishikuar rreth 400 akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorët e lidhur me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Matrica përbën një instrument i cili do të ndihmojë të dy nivelet e qeverisjes në vend të harmonizojnë kuptimin e kuadrit ligjor dhe institucional në fuqi që lidhet me funksionet e vetëqeverisjes vendore.

Zbatimi i rekomandimeve të prezantuara në raportin e Matricës do të kërkojnë rishikimin e Strategjisë dhe të afateve kohore të saj, por edhe burimet financiare e njerëzore të cilat do të kërkohen për të mundur përballjen me sfidën e vazhdueshme për decentralizim dhe demokraci.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

- Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

PËRFITUES:

- Ministria e Brendshme

KOHËZGJATJA:

- 10/2018 - 02/2019

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.